

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

- “Pastrimi i Akuatoriumit për 3 vite”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Shërbime ujore detare – 98361000-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

- **23.199.199** (njëzet e tre milion e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor – **Autoriteti Portual Durrës** – ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas shtojcës 8, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe shtojcës 9 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një me vlerë të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën, dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizura gjatë tre viteve të fundit nga nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Si dëshmi për përvojën e mëparshme Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 41, pikat 2 e 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare, me:

- a) **Çertifikatë ISO 9001:2015** të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësisë, dhe/ose të njëvlefshme me to që mund të garantojnë cilësinë e shërbimeve të kërkuara, objekt i tenderit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) **Çertifikatë ISO 14001:2015** të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të mjedisit, dhe/ose të njëvlefshme me to që mund të garantojnë cilësinë e shërbimeve të kërkuara, objekt i tenderit, sistem menaxhimi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) **Çertifikatë ISO 45001:2018** të standartit ndërkombëtar të Sistemi të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë , dhe/ose të njëvlefshme me to që mund të garantojnë cilësinë e shërbimeve

të kërkuara, objekt i tenderit, sistem menaxhimi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përmbushja e standartit ISO 9001:2015 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kërkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

Përmbushja e standartit ISO 14001: 2015 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që Operatori Ekonomik është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës, duke garantuar menaxhimin e mjedisit.

Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të mjedisit për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të menxhimit të mjedisit.

Përmbushja e standartit ISO 45001: 2018 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që Operatori Ekonomik është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës, duke garantuar shëndetin dhe sigurinë në punë.

Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.3 Leje Mjedisi me kod III.1.A ose kod III.1.B për grumbullim, përpunim dhe riciklim të mbetjeve portuale, në kategorinë “menaxhimi i mbetjeve”.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është vendosur për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat e Ligjit Nr.10 448, datë 14.07.2014 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar me Ligjin 52/2020, ligji 10081, datë 23.02.2009 “Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, ligji 1046, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe VKM 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Operatori duhet të jetë i pajisur me lejen përkatëse mjedisore për të kryer veprimtarinë e pastrimit të akuariumit nga mbetjet e ngurta dhe të lengeta hidrokarbure dhe kryerjen e operacioneve të sigurta deri në asgjësimin perfundimtar të mbetjeve sipas legjislacionit mjedisor në fuqi.

2.3.4 Licensë profesionale me kod III.2.B “Për transportim, grumbullim, të mbetjeve jo të rrezikshme”.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është vendosur për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat e Ligjit Nr.10 448, datë 14.07.2014 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar me Ligjin 52/2020, ligji 10081, datë 23.02.2009 “Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, ligji 1046, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe VKM 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Operatori duhet të jetë i pajisur me licencën përkatëse për transportin e mbetjeve hidrokarbure dhe të ngurta sipas legjislacionit në fuqi të sipërcituar konkretisht në nenet 57, 58 të Ligjit 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

2.3.5 Licensë profesionale me kod VII.5.2 “Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në Autoritetin Portual Durrës”.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është vendosur për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat e Ligjit 10081, datë 23.02.2009 “Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, ligji 1046, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe VKM 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, Udhëzimi Nr. 2565, datë 23.5.2016, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarive të shërbimeve portuale, shkaqet e pezullimit apo revokimit të tyre”.

2.3.6 Akt-Marrëveshje e lidhur midis Operatorit ekonomik dhe një Landfilli të miratuar dhe licensuar për depozitim të mbetjeve urbane të ngurta jo të rrezikshme.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është vendosur për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat e Ligjit Nr.10 448, datë 14.07.2014 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar me Ligjin 52/2020, ligji 10081, datë 23.02.2009 “Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, ligji 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, VKM Nr. 229, date 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 9 (nëntë) punonjës.

Kjo do të vërtetohet me dorëzimin e dokumenteve vijuese:

- Listë pagesat e konfirmuara nga Organet Tatimore për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit.
- Vërtetim që ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, për të paktën 3 muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të pasqyrohet numri i punonjesve për çdo muaj.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm vjen si nevojë e përmbushjes së detyrimeve parashikuar në termat e referencës, ku stafi i punëtoreve do kryejë dhe asistojë në proceset e pastrimit të akuatoriumit, pilotimit të mjeteve, grumbullimit dhe transportit të mbetjeve të krijuara. Udhëzim Nr. 2565, datë 23.5.2016, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarive të shërbimeve portuale, shkaqet e pezullimit apo revokimit të tyre”.

2.3.8 Kualifikimet e nevojshme për stafin operativ janë, si vijon:

- Minimalisht 1 (një) punonjës i pajisur me Leje Drejtimi kategoria CE dhe ADR (obligative për drejtimin e Autobotit të vajrave).
- Minimalisht 2 (dy) punonjës i pajisur me Leje Drejtimi Kategoria C (Obligative për drejtimin e Automjetit teknologjik të trajtimit të mbetjeve urbane dhe Automjet vetëshkarkues për mbledhjen e mbetjeve).
- Minimalisht 4 (kater) punonjës të pajisur me Pashaporten e detarit / Kartën e detarit (Obligative sipas Kodit Detar për përdorimin e mjeteve detare).
- Minimalisht 2 punonjës të pajisur me Dëshminë e Aftësisë për Drejtimin e Mjetit lundrues me klasifikim SKIPER (Obligative sipas Kodit Detar për drejtimin e mjetit lundrues për grumbullimin e mbetjeve të ngurta dhe vajore dhe Anijes Teknologjike me kosh).

Argumentimi:

Kriteri i mesiperm është vendosur referuar Kodit detar të republikës së Shqipërisë si dhe nevojës për staf të kualifikuar diktuar nga përdorimi mjeteve tokësore dhe detare të kerkuara bazuar në Udhëzim Nr. 2565, datë 23.5.2016, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarive të shërbimeve portuale, shkaqet e pezullimit apo revokimit të tyre”.

➤ **Kapacitetet teknike për realizimin e shërbimit.**

Mjetet detare

2.3.9 Autobot për grumbullimin e mbetjeve vajore nga ndotja e akuariumit dhe transportin e tyre tokësor për në pikën e riciklimit - copë 1, vërtetuar me Certifikatën e Pronësisë së mjetit ose kontratë qeraje (origjinale ose e noterizuar) e vlefshme për të gjithë periudhën e kontratës me Autoritetin Kontraktor. Bashlidhur Leja e qarkullimit, Sigurimi i detyrueshem TPL, Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjetit dhe Leje Transporti dhe “Çertifikatën e miratimit ADR të mjetit”.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është vendosur për të mundësuar grumbullimin e mbetjeve të ngruta dhe vajore sipas Udhëzim Nr. 2565, datë 23.5.2016 “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarive të shërbimeve portuale, shkaqet e pezullimit apo revokimit të tyre” dhe Termave të Referencës. Numri minimal i autoboteve është vene për të mos qene diskriminues për operatorët pjesëmarrës në tender pasi nevojat e Autoritetit Portual bazuar në eksperiencën disavjecare është vetëm për një të tillë referuar fluksit të punës.

2.3.10 Automjet teknologjik të trajtimit të mbetjeve urbane - copë 1, vërtetuar me Certifikatën e Pronësisë së mjetit ose kontratë qeraje (origjinale ose e noterizuar) e vlefshme për të gjithë periudhën e kontratës me Autoritetin Kontraktor. Bashlidhur Leja e qarkullimit, Sigurimi i detyrueshem TPL, Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjetit dhe Leje Transporti.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është vendosur për të garantuar kryerjen e shërbimit të tërheqjes së mbetjeve të ngruta nga konteneret metalikë sipas Udhëzim Nr. 2565, datë 23.5.2016, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarive të shërbimeve portuale, shkaqet e pezullimit apo revokimit të tyre” dhe Termave të Referencës.

2.3.11 Automjet vetëshkarkues për mbledhjen e mbetjeve urbane riportabël për marrjen e mbetjeve të ngruta nga koshat/kontenerët dhe evadimin në një landfill të licensuar- copë 1,

vërtetuar me Certifikatën e Pronësisë së mjetit ose kontratë qeraje (origjinale ose e noterizuar) e vlefshme për të gjithë periudhën e kontratës me Autoritetin Kontraktor. Bashlidhur Leja e qarkullimit, Sigurimi i detyrueshem TPL , Certifikata e Kontrollit Teknik te Mjetit dhe Leje Transporti.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është vendosur për te garantuar kryerjen e shërbimit të tërheqjes së mbetjeve të ngurta nga kontenieret metalikë për ti evaduar tek një landifill i licensuar sipas Udhëzimit Nr. 2565, datë 23.5.2016, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarive të shërbimeveportuale, shkaqet e pezullimit apo revokimit të tyre” dhe Termave të Referencës.

2.3.12 Impiant për Riciklimin e Mbetjeve Vajore/Hidrokarbure, ose kontratë qiraje me kompani që zotërojnë Impiant Riciklimi për Mbetjet Vajore/Hidrokarbure, të jetë i çertifikuar me ISO 9001, ISO 14001 dhe 45001:2018 dhe Impianti i Riciklimit duhet të ketë Gen-planin e vendosjes së depove ku do depozitohen mbetjet e lëngëta të tërhequra nga anijet, i firmosur nga arkitekti/inxhinieri i licensuar dhe kapacitetet e tyre të shoqëruara me aktin e pronësisë/kontratën e qirasë apo kontratën e përdorimit me subjektin që i ka këto depozita.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është vendosur për te garantuar riciklimin e mbetjeve vajore dhe hidrokarbure të gjeneruar nga procesi i pastrimi të akuatoriumit sipas Termave të Referencës. Udhëzim Nr. 2565, datë 23.5.2016, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarive të shërbimeveportuale, shkaqet e pezullimit apo revokimit të tyre”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose

produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në dokumentet mbi Termat e Referencës, bashkëlidhur dokumenteve standarte të tenderit, janë përcaktuar, me detajimet e nevojshme, të gjithë pikat dhe kriteret e specifikimeve teknike, për kontratën e prokurimit me objekt “Pastrimi i Akuatoriumit për 3 vite”.